

OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

MANUAL PËR BIZNESET

Një manual që bizneset të përvetësojnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe të angazhohen se do të ndërmarrin ndryshime në të mirën e të ardhmes tonë dhe përmirësimin e qyteteve, qytezave, komuniteteve dhe industrive tona.



FALENDERIM

“Ky dokument u hartua fillimisht nga ICC Irlandë dhe Dhoma e Tregtisë Irlandë dhe është përshtatur në gjuhën shqipe. E drejta e përkthimit në gjuhën shqipe është mundësuar për ICC Albania.”



TABELA E LËNDËS

02

FALENDERIM

04

HYRJE

06RËNDËSIA
PËR
BIZNESIN**09**SI TË FILLOJMË PUNËN ME
OZHQ**13**MJETET GLOBALE
NGA ICC**16**MËNYRAT SE SI MUND TË
ZBATOHEN OZHQ-TË NË
BIZNESIN TUAJ**22**17 OBJEKTIVAT
E ZHVILLIMIT TË
QËNDRUESHËM**31**BURIME
TË TJERA
INFORMACIONI

04

HYRJE



Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, miratuar nga të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në 2015, siguron një plan të përbashkët për paqen dhe prosperitetin për njerëzit dhe planetin, tani dhe në të ardhmen. Në zemër të saj janë 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG). Këto Objektiva janë një thirrje urgjente për veprim ku pranohet rëndësia e partneritetit midis të gjitha vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. SDG-të pranojnë se zhdukja e varfërisë dhe dëmeve të tjera duhet të shkojnë paralelisht me strategjitë që përmirësojnë shëndetin dhe arsimin, zvogëlojnë pabarazinë dhe nxisin rritjen ekonomike, ndërsa trajtojnë ndryshimet klimatike dhe punojnë për të ruajtur pyjet e oqeanet tanë. Bizneset në të gjithë botën duhet të luajnë rolin e tyre.

Sfidat globale, sikurse ndryshimet klimatike, mungesa e burimeve si uji dhe ushqimi, varfëria, konfliktet apo pabarazia, kërkojnë zgjidhje po aq sa të menjëhershme aq edhe të qëndrueshme. Sektori privat, përmes kompanive të mëdha dhe të vogla, pavarësisht fushës ku operojnë, është një aktor shumë i rëndësishëm që kontribuon drejtpërsëdrejti për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Ndërkohë që kërkohet ky transformim në modelet dhe sistemet e biznesit të së ardhmes, për të zgjidhur sfidat shoqërore përmes inovacionit dhe bashkëpunimit, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

u imponojnë kompanive që së pari të bëjnë biznes me përgjegjësi dhe integritet.

Shkalla dhe shtrirja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm është e gjerë dhe e thelluar dhe për rrjedhojë kompanitë nuk e kanë gjithmonë të lehtë t'i përkthejnë ato në modele dhe sisteme biznesi. Për këtë arsye po i sjellim kompanive shqiptare këtë udhëzues për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Qëllimi kryesor i këtij Manuali është të sjellë një thjeshtësi, strukturë dhe udhëzime praktike për atë që mund të duket si një perspektivë shqetësuese për të gjithë ne. 17 Objektivat janë krijuar në mënyrë që organizatat, bizneset dhe komunitetet të mund të identifikojnë Objektivin/Objektivat në të cilat ata mendojnë se mund të japin një kontribut, sado i madh apo i vogël. Shpresojmë që ky Manual do të frymëzojë dhe inkurajojë shumë pronarë dhe menaxherë biznesesh, duke i ndihmuar ata të kuptojnë se si ndryshimet e fundit në vendin e tyre të punës, si rezultat i ngjarjeve të jashtme, të tilla si Covid-19, kontribuojnë në mënyrë aktive në Objektiva të veçanta dhe i motivojnë ata të ndikojnë më tej në këtë fushë.

06

RËNDËSIA PËR BIZNESIN

Biznesi luan një rol themelor në mbështetjen dhe arritjen e shumë prej Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Nga ana tjetër, Objektivat ndihmojnë në krijimin e komuniteteve më të forta, mjedise më të mira pune, mundësi të qëndrueshme tregtare dhe do të sigurojnë të ardhmen e ekonomisë dhe punësimit tonë, si në Shqipëri ashtu edhe në të gjithë globin. OZHQ-të na kërkojnë të përshtatemi, të jemi novatorë dhe të bëjmë disa ndryshime; megjithatë, ato janë krijuar me ambicien për të na siguruar në përgjithësi një të ardhme më të mirë.

Biznesi, industria dhe Qeveria duhet të punojnë së bashku drejt arritjes së OZHQ-ve për të mundësuar që të shohim efektet e tyre në mënyrë sa më domethënëse. Prandaj duhet të bëjmë ndryshime, duke filluar me përshtatjen e zinxhirëve tanë të furnizimit apo duke ndërmarrë hapa për të korrigjuar problematikat brenda industrive tona, duke reflektuar së brendshmi, për të bërë ndryshime në mënyrën se si jetojmë jetët tona jashtë biznesit. Së bashku, ne mund të sjellim ndryshim në Shqipëri dhe përtej, ndërkohë që punojmë për përmbushjen e ambicies së përbashkët dhe mundësisë që sjellin Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

PËRFITIMET PËR BIZNESIN TUAJ

Ju ende mund të pyesni, se cilat janë përfitimet që mund të vijnë nga përafrimi i biznesit tim me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm? Kompanitë që janë angazhuar të përfshijnë Objektivat specifike në praktikat dhe politikat e tyre të biznesit, raportojnë se po shohin përfitime afatgjata në biznesin e tyre, të tilla si:

- » Rritje në marzhin e fitimit dhe rritje e nivelit të kursimeve në biznesin e tyre¹
- » Rritje e besimit mes klientëve të tyre²
- » Lidhja e kontratave të reja duke u bërë thirrje bizneseve që kërkojnë të zbatojnë zinxhirë më të qëndrueshëm furnizimi³
- » Përmirësim i nivelit të ruajtjes së vendeve të punës duke punuar drejt një qëllimi të përbashkët me punonjësit⁴
- » Rritje e ndjenjave të qëndrueshmërisë duke zhvilluar plane të qëndrueshme për të ardhmen⁵
- » Rritje e bazës së klientëve duke tërhequr konsumatorë me vizion në qëndrueshmëri⁶
- » Përmirësim i performancës pasi menaxhimi dhe stafi punojnë me një ndjenjë më të lartë për arritjen e qëllimit⁷
- » Forcim i marrëdhënieve me stafin, grupet e interesit dhe partnerët⁸



REFERENCA

1. McKinsey: Profits with purpose: How organizing for sustainability can benefit the bottom line, July 2014
2. 2021 Edelman Trust Barometer
3. A More Sustainable Supply Chain: V. H. Villena And D. Gioia In Harvard Business Review, 2020.
4. Life is Better Filtered: Corporate School of Expertise
5. Deloitte - 2030 Purpose: Good business
6. Nielsen: A 'natural' rise in sustainability around the world
7. Deloitte - 2030 Purpose: Good business
8. 2019 Edelman Trust Barometer global report

OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM



MË SHUMË DETAJE RRETH SECILIT OBJEKTIV GJENDEN NË FAQE 22 →

09

SI TË FILLOJMË PUNËN ME OZHQ

Nëse jeni të pasigurtë se ku duhet ta filloni udhëtimin e kompanisë suaj për të punuar në harmoni me OZHQ-të, këtu janë disa këshilla për të filluar. Shkarkoni udhëzuesin tonë "Si të fillosh" për t'ju ndihmuar në vendimin tuaj.

KLIKONI KËTU PËR TË SHKARKUAR DOKUMENTIN 'SI TË FILLOSH'



| HAPI I PARË | NDËRMARRJE E VOGËL | ✓ | NDËRMARRJE E MADHE | ✓ |
|-------------------|---|---|---|---|
| PËRGGATITU | Shpjegojini konceptet e OZHQ-ve pronarit/menaxhimit dhe punonjësve. | | Siguroni mbështetje nga pjesa tjetër e punonjësve të ekipit të lartë të menaxhimit. | |
| | Merrni leje për të mbajtur takime të shkurtra me punonjësit për të përcaktuar se çfarë duhet bërë. | | Takohuni me departamente të ndryshme për të përcaktuar sesi ata mund të mbështesin Objektivat në fushën e tyre. | |
| | Angazhohuni dhe caktoni kohë për të planifikuar dhe zbatuar programet. | | Siguroni angazhimin e Bordit, planifikoni dhe organizoni aktivitete dhe takime shtesë. | |
| | Ndihmoni pronarin/bashkëpunëtorin të zhvillojë një politikë të shkurtër në lidhje me angazhimin ndaj Objektiveve. | | Filloni të zhvilloni një statut OZHQ-sh për kompaninë tuaj. | |
| ANGAZHOHU | Kërkoni 2-3 vullnetarë për të krijuar një grup pune për OZHQ-të. | | Krijoni një komitet prej 10-15 personash që përfaqësojnë departamente dhe vende të ndryshme pune. | |
| | Nëse ka role të ndryshme në kompani, merrni punonjës nga çdo fushë për të ndihmuar. | | Zhvilloni termat e referencës për këto grupe nëse është e nevojshme. | |
| | Mund të përfshini ekspertë nga ndërmarrje më të mëdha ose shoqatat e komunitetit, të cilët janë të gatshëm për të ndihmuar. | | Nëse korporata funksionon në vende të ndryshme, ngrini nënkomitetet rajonale. | |
| | Gjeni një hapësirë për t'u takuar dhe mbledhur materialet e nevojshme. | | Siguroni përfaqësim nga të gjitha pjesët e biznesi. | |

| HAPI NJË | NDËRMARRJE E VOGËL | ✓ | NDËRMARRJE E MADHE | ✓ |
|-----------------------|---|---|--|---|
| VLERËSO | Merrni informacione të mëtejshme mbi OZHQ-të dhe si lidhen ato me industrinë tuaj. | | Mblidhni të dhëna demografike në lidhje me fuqinë punëtore të kompanisë. | |
| | Përcaktoni praktikat e mira vendore dhe konsultohuni sipas rastit me ekspertë të jashtëm. | | Kryeni një studim konfidencial dhe gjithëpërfshirës për të gjithë personelin, për t'i pyetur për shqetësimet e tyre për mirëqenien shëndetësore dhe fusha të tjera në lidhje me OZHQ-të. | |
| | Drejtoni një diskutim me punonjësit në lidhje me OZHQ-të. Përfshini familjen dhe komunitetin sepse ata kanë lidhje me punën. | | Pyesni punonjësit se çfarë do të donin të bënin për të përmirësuar angazhimin e tyre lidhur me OZHQ-të dhe merrni mendimin e tyre për mënyrën se si punëdhënësi mund të ndihmojë. | |
| | Shkëmbeni ide mbi atë që punonjësit dhe punëdhënësi mund të bëjnë për t'i bërë gjërat më mirë. | | Bëni një kontroll gjithëpërfshirës të angazhimit të kompanisë dhe rishikoni rezultatet. | |
| | Kontaktoni pronarin/bashkëpunëtorin veçmas për të kërkuar idetë e tij/saj. | | - | |
| JEPI PËRPARËSI | Listoni problemet dhe zgjidhjet dhe kërkonin nga njerëzit që të përzgjedhin 3 më kryesoret. | | Zhvilloni plane vjetore me plane veprimi të detajuara për çdo aktivitet specifik, program ose politikë të re. | |
| | Kontaktoni pronarin/bashkëpunëtorin veçmas për të kërkuar idetë e tij/saj. | | Jepini përparësi duke lidhur fushat "kam shumë nevojë" me fushat "kam shumë dëshirë" të punonjësve. | |
| PLANIFIKO | Përdorni idetë e mbledhura nga Grupi i Punës, si dhe idetë e punonjësve ose ndërmarrjeve të tjera. | | Zhvilloni plane vjetore me plane veprimi të detajuara për çdo aktivitet specifik, program ose politikë të re. | |
| | Shkruani planin, bëni një listë të asaj që ju nevojitet për të kryer secilin aktivitet, dhe paraqiteni tek pronari/bashkëpunëtori për miratim ose negociim. | | Vlerësoni sesi aktivitetet tuaja i përgjigjen çështjeve që lidhen me ndërgjegjësimin, njohuritë dhe aftësitë, ndryshimin e sjelljes dhe rregullimet mjedisore ose organizative. | |
| | Planifikoni aktivitete afatshkurtra për t'iu përgjigjur me përparësi nevojave të menjëhershme me projekte më të vogla. | | Planet bazë të veprimit në fazat e ndryshimit - rezultatet dhe qëllimet e procesit, dhe planet e vlerësimit dhe afatet kohore. | |

| HAPI NJË | NDËRMARRJE E VOGËL | ✓ | NDËRMARRJE E MADHE | ✓ |
|------------------|---|---|--|---|
| PLANIFIKO | Zhvilloni një plan afatgjatë për të arritur më shumë projekte të rëndësishme. | | Zhvilloni një plan 3 deri në 5 vjeçar për biznesin. | |
| VEPRO | Zbatoni planet e veprimit me ndihmën e pronarit/ bashkëpunëtorit dhe Grupit të Punës. | | Ndani përgjegjësitë mes anëtarëve të komitetit. | |
| | - | | Organizoni takime mujore ose dymujore për të vlerësuar progresin e të gjitha projekteve. | |
| VLERËSO | Pyesni punonjësit nëse mendojnë se projekti funksionoi dhe çfarë mund të përmirësohet. | | Kryeni një vlerësim të procesit dhe të rezultateve të secilit aktivitet sipas planeve të vlerësimit. | |
| PËRMIRËSO | Bazuar në atë që shihni dhe dëgjoni nga punëtorët, ndryshoni programin për ta përmirësuar atë. | | Rivlerësoni planifikimin 3 - 5 vjeçar të kompanisë suaj dhe përditësojeni atë të paktën çdo vit. | |
| | Filloni me një projekt tjetër bazuar në listën tuaj të përparësive. | | Përsëriteni anketimin çdo dy vjet dhe monitoroni ndryshimet që ndodhin me kalimin e kohës. | |
| | - | | Zhvilloni plane vjetore bazuar në vlerësimet e vitit paraardhës. | |

13

MJETET GLOBALE NGA ICC

SME360XTM

SMALL & MEDIUM ENTERPRISES THREE SIXTY

Mjeti Juaj për t'u Bërë më të Gjelbër dhe Konkurrues

ICC Albania vepron si Komiteti Kombëtar i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë për Shqipërinë, që e lejon atë të komunikojë pikëpamjet e ICC-së mbi klimën e biznesit, tregtinë ndërkombëtare dhe investimet tek qeveria, bizneset dhe palët e tjera të interesit në të gjithë Shqipërinë. Si pjesë e angazhimit të ICC-së ndaj OZHQ-ve, gjatë aktiviteteve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të mbajtura në shtator 2021, ICC dhe GIST prezantuan SME360X.

ÇFARË ËSHTË SME360X?

SME360X është një platformë SaaS (Softuer si Shërbim) e bashkëkrijuar nga ICC-ja dhe GIST-i dhe mat ndikimet e operacioneve të biznesit në mjedis. Vlerësimi bazohet në treguesit kryesorë të performancës më poshtë:



**emetimet e
gazrave serë**



**konsumimi
i ujit**



**ndotja
e ajrit**



**ndotja e ujit
dhe sterës**



**përdorimi i
tokës**



**gjenerim i
mbetjeve**

SME360X u mundëson sipërmarrësve të krahasojnë veten me konkurrentët e tyre rajonalë, kombëtarë dhe sektorialë. Kjo platformë do të fuqizojë bizneset e vogla që të marrin vendime më të qëndrueshme dhe të bëhen më fitimprurëse. Platforma mundëson këshilla pragmatike për ndërmarrjen e veprimeve të përgjegjshme nga kompanitë ndaj mjedisit.

REGJISTROHUNI NË APLIKACION

Regjistrimi paraprak për SME360X do t'ju japë mundësinë të provoni mjetin dhe të na ofroni reagime, në mënyrë që të plotësojmë më mirë nevojat tuaja. Ju gjithashtu do të jeni në gjendje të merrni pjesë në trajnime dhe sesione mësimore të përqendruara në vlerësime cilësore dhe sasiore të ndikimit në mjedis.

LEXONI BROSHURËN



REGJISTROHUNI PARAPRAKISHT



16

MËNYRAT SE SI MUND TË ZBATOHEN OZHQ-TË NË BIZNESIN TUAJ



Në këtë Udhëzues janë përpiluar mbi 70 sugjerime për mënyrën se si bizneset mund të mbështesin OZHQ-të dhe t'i zbatojnë ato në kompaninë e tyre. Disa nga këto sugjerime që të kenë sukses kërkojnë vetëm përkushtimin e stafit dhe menaxhimit, ndërsa disa të tjera kërkojnë gjithashtu edhe angazhim financiar. Këto mundësi përfshijnë të gjitha nivelet e angazhimit dhe aftësitë për të frymëzuar biznesin tuaj që të mbështesë dhe përfshihet në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Çdo sugjerim ndiqet nga numri përkatës i të paktën një Objektivit me të cilin ndërlidhet.

SHËNDETI DHE MIRËQENIA

1. Ofroni mundësi për ushqim te shëndetshëm në vendin e punës, kuti ushqimesh nga prodhuesit vendas. (2, 3, 12)
2. Nëse ofroni drekën pa pagesë, kërkoni që të ofrohet nga bizneset vendase që nxisin qëndrueshmërinë dhe përdorin prodhime sezonale. (2, 3, 11, 12, 13)
3. Sigurohuni se jeni duke ofruar mundësi për ushqim në vendin e punës që përputhet me të gjitha dietat. (2, 3, 10)
4. Organizoni klasa gatimi për stafin, që të nxisni praktika më të shëndetshme të të ushqyerit dhe që përmirësojnë mirëqenien e përgjithshme. (2, 3)
5. Sigurohuni që mirëqenia në punë të jetë një përparësi, regjistrohuni në një program asistence për punonjësit. (3, 8)
6. Ofroni regjistrim në palestër për stafin ose në klasa ushtrimesh fizike sipas zgjedhjes së tyre. (3, 8)
7. Krijoni grupe pune me natyrë sociale për të organizuar aktivitete për stafin, që mundësojnë krijimin e një bashkësie më të fortë në vendin e punës dhe që ndihmon në mbajtjen e stafit. (3, 8)
8. Ofroni financim të plotë ose të pjesshëm, në sigurimin shëndetësor ose dentar për stafin. (3, 8)
9. Prezantoni kurse për mirëqenien financiare për stafin dhe jepini punonjësve pension ESG¹ dhe opsionet për investime. (3, 8)

BARAZIA DHE DIVERSITETI

10. Nëse nuk mund ta shihni, nuk mund të jeni. Angazhohuni për të promovuar në mënyrë të dukshme barazinë gjinore brenda vendit të punës. (5, 8, 10)
11. Kërkoni përfaqësim gjinor në takimet dhe aktivitetet e biznesit. (5, 10)
12. Ofroni mbështetje për kujdesin e fëmijëve, për të mbështetur familjet në sektorin tuaj. (5, 10)
13. Angazhohuni për diversifikimin e fuqisë tuaj punëtore. (5, 10)
14. Përditësoni nismat e punësimit për të nxitur më shumë aplikime nga grupet me përfaqësim të ulët dhe minoritetet. (10)

15. Punoni me biznese të tjera që mbështesin gratë. (5, 10, 17)
16. Publikoni njoftimet për vende pune, tek kompanitë që punojnë me grupet me përfaqësim të ulët, duke përfshirë të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara ose minoritetet etnike. (10, 17)
17. Përshtatni ndërtesën/zyrën tuaj në mënyrë që të jenë të aksesueshme për karriget me rrota dhe për pajisjet e ndryshme që ndihmojnë në lëvizje. (10)
18. Ndërmerrni fushata ndërgjegjësimi për të përmirësuar mënyrën se si sektori juaj e prezanton veten tek gratë – sigurohuni që gratë të jenë të dukshme përgjatë fushatave të jashtme të reklamimit. (5, 10)
19. Nxisni vendimarrjen gjithëpërfshirëse në kompani. (10, 16)
20. Zbatoni barazinë gjinore në nivel menaxhimi dhe bordi. (5, 8, 10, 16)
21. Përdorni teknologjinë për të larguar çdo formë paragjykimi ndaj kandidatëve gjatë procesit të punësimit. (5, 8, 9, 10)
22. Prezantoni leje të paguar më të gjatë lindjeje ose leje lindjeje të barabartë për baballarët të barazuar mundësinë e prindërve për t'u kthyer në punë apo ndarë ngarkesën e punës pasi janë bërë me fëmijë. (5, 8, 10)



¹ Environmental, Social, Governance

KONSUM I VETËDIJSHËM

23. Sigurohuni që ndërtesa juaj të ketë praktika efikase për konsumin e ujit. (6, 12)
24. Kaloni te furnizuesit e energjisë së gjelbër. (7, 12, 13, 15)
25. Kaloni në përdorimin e automjeteve elektrike (AE) nëse ofroni makina nga kompania. (7, 12, 13)
26. Financoni pikat për ringarkimin e baterive të makinave elektrike në vendin e punës për të nxitur stafin të kalojë në AE. (7, 12, 13)
27. Ndërmerrni një audit për konsumin e energjisë. (7, 12, 13)
28. Kaloni në opsionet për ndriçim më eficient në ndërtesën tuaj. (7, 12, 13)
29. Izoloni ndërtesën e zyrave tuaja. (7, 12, 13)
30. Kryeni trajnim për menaxhimin e energjisë në bashkëpunim me autoritetet ose ekspertët përkatës. (7, 12, 13)

VENDE PUNE TË PËRSHTATURA ME NEVOJAT E PUNONJËSVE

31. Rimendoni javën “40 orëshe” në vendin tuaj të punës. (3, 8)
32. Lejoni personelin të ndërmarrë studime të mëtejshme duke i ofruar orë fleksibel ose financim të plotë/të pjesshëm për kurset e trajnimit. (4, 8, 10)
33. Paguani stafin me një pagë që mundëson jetesën. (1, 8)
34. Mundësojini stafit tuaj të punojë me orë fleksibile dhe/ose të punojë në distancë. (3, 8)
35. Mbështesni përdorimin e hapësirave të përbashkëta lokale të punës, duke i mundësuar stafit të punojë atje ose ndihmoni bizneset duke ndarë dijet me ta në qendër. (8, 11)
36. Ofroni trajnim punonjësve në mënyrë që ata të mësojnë teknologji dhe sisteme të reja. (4, 8)
37. Prezantoni javën e punës me 4 ditë. (3, 8)
38. Miratoni një model pune të bazuar në projekte për të mundësuar fleksibilitet në mënyrën se si punon stafi juaj. (8, 9)

ZBATONI INOVACION

39. Ofroni ekspertizën tuaj për startup-et/start-up inovative. (4, 9, 17)
40. Ndërtoni dhe provoni modele dhe teknologji të reja biznesi brenda vendit tuaj të punës dhe raportoni për suksesin e tyre në mënyrë që të tjerët të ndjekin shembullin tuaj. (8, 9, 17)
41. Financoni projekte brenda shkollave dhe komuniteteve tuaja lokale që ofrojnë edukim lidhur me OZHQ-në që po mbështetni - aftësi kompjuterike, biodiversitet, riciklim, barazi. (4, 9, 11, 17)
42. Zhvendosni funksionet e biznesit në rrjet me qëllim që të mund të aksesohet në mënyrë të sigurt dhe në distancë. (8, 9)
43. Bëni ndryshime në biznesin tuaj që përputhen me Strategjitë Kombëtare. Digjitale, nëse ka. (8, 9)



BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN

44. Bashkëpunoni me Dhomat e Tregtisë, shoqatat dhe autoritetet lokale për t'u përfshirë në projekte me fokus biznesin për t'u bërë më të qëndrueshëm në zonën tuaj. (11, 17)
45. Regjistrohuni në programet e policimit në komunitet, nëse ka, për t'i bërë qendrat e qyteteve më të sigurta për të punuar, jetuar dhe bërë biznes. (11, 17)
46. Mbështetni futjen/rritjen e shërbimeve të transportit publik dhe më shumë infrastrukturë në dispozicion për çiklistët dhe këmbësorët në zonën tuaj. (11, 13)
47. Mbështetni nismat lokale për të "shfrytëzuar më mirë hapësirën" dhe për të përdorur vendet e mundshme të parkimit si hapësirë për të ngrënë në natyrë, në kafenetë dhe restorantet lokale. (11, 17)
48. Përdorni platformën tuaj për të mbështetur nismat e "Blerjes së produkteve vendase". (11, 17)
49. Mbështesni dhe financoni festivale ushqimesh ose ofroni shërbimet tuaja për aktivitete lokale. (11, 17)
50. Merrni parasysh mundësinë për të zhvendosur e biznesit tuaj/zyrat dytësore jashtë qyteteve, për të mbështetur ekonomitë lokale dhe për të përmirësuar zhvillimin rajonal. (9, 11)
51. Nxisni punonjësit të përfshihen me komunitetet e tyre duke mbështetur punën vullnetare. (8, 11, 17)
52. Prezantoni programet e stazhit dhe praktikës për të futur grupe të marginalizuara në sektorin tuaj të biznesit. (4, 8, 10)
53. Mentoroni në shkolla/institucione të arsimit profesional lidhur me rrugën drejt punësimit. (4, 8, 10)
54. Ofroni praktika me pagesë për të siguruar që kjo mundësi të jetë e arritshme për të gjithë. (4, 8, 10)

MBROJTJA E PLANETIT

55. Nxisni riciklimin dhe pakësimin e mbeturinave në të gjithë biznesin. (12, 13, 14, 15)
56. Përfshihuni në ekonominë qarkulluese dhe gjeni mënyra novatore për të ripërdorur materialet e mbetjeve nga biznesi juaj. (12, 13, 14, 15)
57. Punoni me furnizues që përdorin ose kërkojnë që atyre të përdorin paketime të ripërdorshme ose të biodegradueshme. (12, 13, 14, 15)
58. Mos përdorni materiale plastike me një përdorim në vendin e punës. (12, 13, 14, 15)
59. Nëse përdorni kimikate ose substanca të dëmshme në vendin tuaj të punës, punoni me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes së Mjedisit për gjetjen e zgjidhjeve për të ulur ndikimin negativ në mjedis. (12, 13, 14, 15)
60. Organizoni përdorimin e makinave në dispozicion në grupe në dispozicion për të ulur emetimet e karbonit nga stafi juaj. (12, 13)
61. Sigurohuni që stafi të ketë mundësi të bëhet pjesë e programit të Qeverisë/Bashkisë "shko me biçikletë në punë". (13)
62. Sigurohuni që ka vend parkimi të disponueshme pranë vendit të punës. (13)
63. Kërkoni përdorimin e produkteve pastruese brenda vendit të punës që nuk dëmtojnë mjedisin. (13, 14, 15)
64. Shfrytëzoni mundësitë e financimit të gjelbër për t'u angazhuar më tej në agjendën e zhvillimit të qëndrueshëm. (8, 13)
65. Shfrytëzoni hapësirat e lira të gjelbra për të rritur biodiversitetin, mbillni bimë miqësore ndaj bletëve ose krijoni një kopsht komunitar për stafin. (11, 13, 14, 15)
66. Ofrojeni punonjësve transport falas ose mbuloni shpenzimet e transportit të tyre duke nxitur më shumë përdorimin e transportit publik. (13)

UDHËHEQJA DHE INTEGRITETI

67. Sigurohuni që të keni mbrojtje të fortë për sinjalizuesit brenda biznesit tuaj. (16)
68. Zbatoni në mënyrën e duhur kodet e sjelljes kundër abuzimit ose shfrytëzimit në vendin e punës. (16)
69. Përditësoni politikat tuaja për të përfshirë praktika më të qëndrueshme në të gjithë biznesin. (17)
70. Përkrahni mbështetjen nga drejtuesit, për të mundur ndjekjen e një agjendë të qëndrueshme. (17)
71. Bashkëpunoni me biznese që po mbështesin OZHQ-të e ngjashme për të rritur ndikimin tuaj. (17)



22

OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM



17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë një grup ambicioz objektivash që mbulojnë një sërë çështjesh aktuale nga çrrënjësja e varfërisë dhe zvogëlimi i pabarazisë deri në rritjen ekonomike, aksesin në arsim dhe mbrojtja e mjedisit.

Në vazhdim është një përmbledhje e të 17 Objektivave, siç përshkruhen nga Kombet e Bashkuara:

OBJEKTIVI 1

PA VARFËRI



OBJEKTIVI:

Zhdukje e varfërisë, në të gjitha format e saj, deri në vitin 2030.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Në vitin 2015, më shumë se 700 milionë njerëz (10% e popullsisë së botës) jetonin në varfëri ekstreme, me vështirësi për të siguruar nevojat me themelore si shërbime shëndetësore, arsim, qasje në ujë dhe kanalizime.

ÇFARË MUND TË BËJ PËR KËTË?

Sektori privat mund të luajë një rol të rëndësishëm në përcaktimin nëse rritja që ai krijon është përfshirëse dhe kontribuon në uljen e varfërisë. Mund të promovojë mundësi ekonomike për të varfërit. Gjithashtu, përfshirja juaj aktive në hartimin e politikave mund të përmirësojë adresimin e varfërisë. Siguron që të drejtat tuaja të promovohen dhe ndihmon për të mbështetur ndryshimin në jetën e njerëzve dhe komuniteteve.

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 1 →

OBJEKTIVI 2

ZERO URI



OBJEKTIVI:

Zhdukje e urisë, arritja e sigurisë ushqimore, ushqim i përmirësuar dhe nxitje e bujqësisë së qëndrueshme.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

2 miliardë njerëz në mbarë botën nuk kanë rregullisht ushqim të sigurt dhe me vlera ushqyese. Uria ekstreme dhe kequshqyerja mbetet pengesë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe krijon një kurth nga i cili njerëzit nuk mund të dalin lehtë.

ÇFARË MUND TË BËJ PËR KËTË?

Ju mund të bëni ndryshime në jetën tuaj – në shtëpi, si konsumator, në punë dhe në komunitet - duke mbështetur fermerët ose tregjet vendase, duke bërë zgjedhje të qëndrueshme ushqimore, duke mbështetur ushqimin e mirë për të gjithë dhe duke luftuar shpërdorimin e ushqimit.

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 2 →

OBJEKTIVI 3

SHËNDET I MIRË
DHE MIRËQËNIE

OBJEKTIVI:

Të sigurohet jetë e shëndetshme dhe të nxitet mirëqenie për të gjithë.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies është jetike për ndërtimin e shoqërive të zhvilluara. Nevojiten përpjekje të bashkërenduara për të arritur mbulimin universal të shëndetit dhe financim të qëndrueshëm për shëndetësinë.

ÇFARË MUND TË BËJ PËR KËTË?

Mund të filloni duke promovuar dhe mbrojtur shëndetin tuaj dhe të atyre përreth jush, duke rritur ndërgjegjësimin në komunitetin tuaj për rëndësinë e shëndetit të mirë, një mënyrë jetese të shëndetshme, dhe të drejtën e njerëzve për shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor. Ju gjithashtu mund t'i kërkonit llogari qeverisë, drejtuesve vendorë dhe vendimmarrësit e tjerë, për angazhimet e tyre për përmirësimin e shëndetit dhe qasjes së njerëzve në shërbimet e kujdesit shëndetësor.

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 3 →

OBJEKTIVI 4

ARSIM CILËSOR



OBJEKTIVI:

Të sigurohet përfshirje dhe arsim cilësor për të gjithë dhe nxitet të mësuarit gjatë gjithë jetës.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Arsimi mundëson rritjen e lëvizshmërisë socio-ekonomike dhe është çelësi për të shpëtuar nga varfëria. Arsimi ndihmon në zvogëlimin e pabarazive, arritjen e barazisë gjinore dhe është vendimtar për nxitjen e tolerancës dhe shoqëritë më paqësore.

ÇFARË MUND TË BËJ PËR KËTË?

T'u kërkojmë qeverive tona ta vendosin arsimin si një përparësi si në politikë ashtu edhe në praktikë. Loboni me qeveritë që të marrin angazhime të qëndrueshme ndaj ofrimit të arsimit falas në shkollën fillore për të gjithë, duke përfshirë grupet në nevojë ose të marginalizuara.

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 4 →

OBJEKTIVI 5

BARAZI GJINORE



OBJEKTIVI:

Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Gratë dhe vajzat përfaqësojnë gjysmën e popullsisë dhe përbëjnë gjysmën e potencialit të saj. Por pabarazia gjinore përsëritet kudo dhe pengon përparimin shoqëror. Gratë janë të nënpërfaqësuar në drejtimin politike dhe kryejnë pjesën më të madhe të punës së papaguar shtëpiake.

ÇFARË MUND TË BËJ PËR TË ZGJIDHUR KËTË ÇËSHTJE?

Ju mund të adresoni paragjykimet tuaja të pavetëdijshme dhe ato brenda sektorit tuaj të punësimit. Inkurajoni biznesin tuaj të heqë barrierat duke siguruar që ka mundësi të barabarta për gratë brenda vendit tuaj të punës. Ju mund të ndërmerrni fushata për gratë dhe mbështesin gratë dhe vajzat për të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 5 →

OBJEKTIVI 6

UJË I PASTËR DHE KANALIZIME



OBJEKTIVI:

Të sigurohet qasje në burimet e ujit të sigurtë dhe kanalizime për të gjithë.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Qasja në ujë, kanalizime dhe higjienë është e drejtë e njeriut. Kërkesa për ujë ka tejkalar rritjen e popullsisë, dhe gjysma e popullsisë së botës tashmë po përjeton mungesë të madhe të ujit të paktën një muaj në vit. Uji është thelbësor jo vetëm për shëndetin, por edhe për uljen e varfërisë, sigurinë ushqimore, paqen dhe të drejtat e njeriut, ekosistemet dhe arsimin.

ÇFARË MUND TË BËJ PËR KËTË?

Organizatet e shoqërisë civile duhet të punojnë për t'i kërkuar qeverisë llogari dhe investojnë në studime për ujërat dhe zhvillim. Duke rritur ndërgjegjësimin dhe ndërmarrë veprime, do të ketë rezultate fitimprurëse dhe qëndrueshmëri e integritet në rritje, si për njerëzit edhe për sistemet ekologjike.

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 6 →

OBJEKTIVI 7

ENERGJI E PËRBALLUESHME
DHE E PASTËR7
ENERGJI
PËRBALLUESHME
DHE E PASTËR

OBJEKTIVI:

Sigurimi i qasjes në energji dhe ofrimi i energjisë të besueshme, të qëndrueshme, të përballueshme, të besueshme dhe moderne për të gjithë.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Një sistem energjetik i rregulluar mirë, mbështet të

gjithë sektorët. Nevojitet vëmendje më e fokusuar për të përmirësuar qasjen në lëndë djegëse dhe teknologji të pastra dhe të sigurta në të gjithë botën.

ÇFARË MUND TË BËJMË PËR T'I ZGJIDHUR KËTO ÇËSHTJE?

- » Mbështetja e investimeve në energjinë e rinovueshme; duke i dhënë përparësi praktikave me efikasitet energjetik, dhe adoptimi i teknologjive dhe infrastrukturën e energjisë së pastër.
- » Bizneset mund të mbulojnë 100% të nevojave funksionale për energji elektrike nga burime të rinovueshme.
- » Punëdhënësit mund të zvogëlojnë kërkesën e brendshme për transport duke i dhënë përparësi telekomunikacionit dhe nxitur mënyrat e gjelbra të transportit.
- » Fikni pajisjet plotësisht kur nuk janë në përdorim.
- » Ju gjithashtu mund të lëvizni me biçikletë, të ecni ose të merrni transport publik, për të zvogëluar emetimet e karbonit.

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 7 →

OBJEKTIVI 8

PUNË DINJITOE DHE
RRITJE EKONOMIKE8
PUNË DINJITOE DHE
RRITJE EKONOMIKE

OBJEKTIVI:

Nxitja e rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim dhe punë të denjë për të gjithë.

ÇFARË DO TË THOTË 'PUNË E DENJË'?

Puna e denjë do të thotë mundësi për të gjithë për të marrë pjesë në punë që është produktive dhe siguron të ardhura të

drejta, siguri në vendin e punës, mbrojtje sociale për familjet, dhe perspektiva më të mira për zhvillim personal dhe integrim shoqëror.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Rritja e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike mund të nxisë përparimin, krijojë vende pune të denja për të gjithë dhe përmirësojë standardet e jetesës.

ÇFARË MUND TË BËJMË PËR T'I ZGJIDHUR KËTO ÇËSHTJE?

Ne mund të sigurohemi që bizneset tona t'u ofrojnë të rinjve mundësi pune të denjë dhe t'u mësojnë aftësi që përputhen me kërkesat e tregut të punës. Për më tepër, të gjithë duhet të kenë qasje mbrojtje sociale dhe shërbimet thelbësore për të barazuar lojën në fushë në mënyrë që të gjithë individët aspirues të arrijnë të kenë punësim produktiv. Qeveritë mund të ndërtojnë ekonomi dinamike, të qëndrueshme, novatore dhe me njerëzit në qendër, duke promovuar punësimin e të rinjve dhe fuqizimin ekonomik të grave.

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 8 →

OBJEKTIVI 9

INDUSTRI, INOVACION
DHE INFRASTRUKTURË

OBJEKTIVI:

Ndërtimi i infrastrukturës së përshtatshme, nxitja e industrializimit të qëndrueshëm dhe inovacionit.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Rritja ekonomike, zhvillimi social dhe veprimet klimatike varen shumë nga infrastruktura, zhvillimi i qëndrueshëm industrial dhe përparimi teknologjik. Përballë një tabloje ekonomike globale që ndryshon me shpejtësi dhe pabarazi në rritje, rritja e qëndrueshme duhet të përfshijë industrializimin, i cili krijon mundësi të arritshme për të gjithë njerëzit, dhe të sigurojë që kjo është mbështetur nga inovacioni dhe infrastruktura me nivel të lartë përshtatshmërie.

SI MUND TË NDIHMOJMË?

EVendosni standarde dhe promovoni rregullore që mundësojnë që projektet dhe nismat e kompanisë të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme. Bashkëpunoni me programet e bamirësisë dhe sektorin publik për të ndihmuar në nxitjen e rritjes së qëndrueshme në vendet në zhvillim. Mendoni për mënyrën sesi industritë tona ndikojnë në jetën dhe mirëqenien tuaj dhe përdorni mediat sociale për të nxitur politikëbërësit t'i japin përparësi OZHQ-ve.

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 9 →

OBJEKTIVI 10

ZVOGËLIM I PABARAZIVE



OBJEKTIVI:

Ulja e pabarazive brenda dhe midis vendeve dhe shoqërive.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

IPabarazia - bazuar në të ardhura, gjini, moshë, aftësinë e kufizuar, orientimi seksual, raca, klasa, përkatësia etnike, feja dhe mundësia - kërcënon zhvillimin afatgjatë social dhe ekonomik, pengon uljen e varfërisë dhe shkatërron ndjenjën e përmbushjes dhe vetëvlerësimit. Pabarazia mund të rrisë kriminalitetin, sëmundjet dhe degradimin mjedisor. Ne nuk mund të arrijmë zhvillim të qëndrueshëm dhe ta bëjmë botën një vend më të mirë për të gjithë nëse ka individë, shoqëri ose vende që përjashtohen nga mundësia për një jetë më të mirë dhe një të ardhme më të begatë.

ÇFARË MUND TË BËJMË NE PËR KËTË?

Reduktimi i pabarazisë kërkon ndryshime transformuese. Ne mundemi të sigurojmë mundësi të barabarta dhe zvogëlojmë pabarazitë në të ardhura nëse heqim ligjet, politikat dhe praktikatat diskriminuese. Qeveritë dhe organizatat e biznesit mund të promovojnë migrimin e sigurt, të rregullt dhe të përgjegjshëm, përfshirë përmes planifikimit dhe politikave të menaxhuara mirë, për miliona njerëz që kanë lënë shtëpitë e tyre në kërkim të një jete më të mirë për shkak të luftës, diskriminimit, varfërisë dhe mungesës së mundësive.

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 10 →

OBJEKTIVI 11

QYTETE DHE KOMUNITETE
TË QËNDRUESHME11 QYTETE DHE
KOMUNITETE TË
QËNDRUESHME

OBJEKTIVI:

Qytete gjithëpërfshirëse, të sigurta, elastike dhe të qëndrueshme për banorët e tyre.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Urbanizimi i shpejtë i qyteteve dhe qytezave tona do të thotë se 4 miliardë njerëz, mbi gjysmën e popullsisë globale, përballen me përkeqësimin e ndotjes së ajrit, infrastrukturë të papërshtatshme, mungesë banesash, shërbimet dhe komoditetin e përshtatshëm, shtrirje e çorganizuar dhe e paplanifikuar urbane.

ÇFARË MUND TË BËJ PËR TA ARRITUR KËTË
OBJEKTIV?

Tregoni interes aktiv për qeverisjen dhe menaxhimin e qytetit tuaj. Kërkoni llojin e qytetit për të cilin besoni se keni nevojë. Zhvilloni një vizion për ndërtesën tuaj, rrugën dhe lagjen, dhe veproni sipas atij vizioni. Sa më të mira kushtet në komunitetin tuaj, aq më i madh është efekti në cilësinë e jetës - A ka punë të mjaftueshme? A mund të ecni fëmijët tuaj të sigurt për në shkollë? A mund të ecni natën me familjen tuaj? Sa larg ndodhet transporti publik më i afërt? A keni ajër me cilësi të mirë? A keni qasje në hapësira të përbashkëta publike të pranueshme?

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 11 →

OBJEKTIVI 12

KONSUM DHE PRODHIM
I PËRGJEGJSHËM12 KONSUMI DHE
PRODHIMI I
PËRGJEGJSHËM

OBJEKTIVI:

Të zbatohet konsum dhe prodhim i qëndrueshëm.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Gjatë shekullit të kaluar, përparimi ekonomik dhe social është shoqëruar me degradimin e mjedisit duke rrezikon vetë sistemet nga të cilat varet zhvillimi ynë i ardhshëm dhe mbijetesa. Kalimi i suksesshëm në konsum dhe prodhim më të qëndrueshëm, do të thotë përmirësim në efikasitetin e burimeve, duke marrë parasysh të gjithë ciklin jetësor të aktiviteteve ekonomike, dhe përfshirje aktive në marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore.

SI MUND TË NDIHMOJ PËR KËTË SI BIZNES?

Është në interesin e bizneseve të gjejnë zgjidhje të reja që mundësojnë modele konsumi dhe prodhimi të qëndrueshëm. Identifikimi i “pikave të nxehta” brenda zinxhirit të furnizimit ku ekziston potenciali më i madh për të përmirësuar përmes ndërhyrjes, duke përmirësuar ndikimin mjedisor dhe social të të gjithë sistemit.

SI MUND TË NDIHMOJ PËR KËTË SI KONSUMATOR?

Ulni sasinë e mbeturinave tuaja, tregohuni të kujdesshëm për atë që blini, sigurohuni të mos e hidhni ushqimin, ulni konsumin tuaj të produkteve plastike dhe bëni blerje të informuara.

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 12 →

OBJEKTIVI 13

VEPRIM PËR KLIMËN

13 VEPRIM
PËR KLIMËN**OBJEKTIVI:**

Ndërmerni veprime për të adresuar ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

2010-2019 ishte dekada më e ngrohtë e regjistruar ndonjëherë, duke sjellë zjarre masive, uragane, thatësira, përmytje dhe fatkeqësi të tjera klimatike në të gjitha kontinentet. Ndryshimi i klimës po prek çdo vend në botë. Është duke dëmtuar ekonominë kombëtare dhe duke prekur jetën dhe mjetet e jetesës, veçanërisht për grupet më në nevojë.

A MUND TA ZGJIDHIM KËTË PROBLEM APO ËSHTË TEPËR VONË PËR TË VEPRUAR?

Për të adresuar ndryshimet klimatike, ne duhet të shtojmë gjërësisht përpjekjet tona. Globalisht janë rritur investimet në energjinë e rinovueshme. Bota duhet të transformojë energjinë, industrinë, transportin, ushqimin, sistemet bujqësore dhe pyjet për të siguruar që ne mundemi të kufizojmë rritjen e temperaturës globale në shumë më pak se 2° C, ndoshta edhe 1.5° C.

ÇFARË MUND TË BËJ PËR TË NDIHMUAR NË ARRITJEN E KËTIJ OBJEKTIVI?

Ne si individë mund të bëjmë shumë (**zbuloni më shumë**) ose lexoni për përpjekjet e **OKB -së për ndryshimet klimatike**.

LEXO MË SHUMË PËR **OZHQ 13** →

OBJEKTIVI 14

JETA NËN UJË

14 JETA
NËN UJË**OBJEKTIVI:**

Mbrojtje dhe përdorim i burimeve nga oqeanet, lumenjtë dhe detet, në mënyrë të qëndrueshme.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Oqeanet janë mbështetja e jetës së planetit tonë dhe rregullojnë sistemin klimatik global. Ato janë ekosistemi më i madh në botë, vendbanimi për gati një milion specie të njohura dhe që përmban një potencial të madh të pashfrytëzuar për zbulime shkencore. Popullsia globale vazhdon të mbështetet tek oqeanet dhe peshkimi për plotësimin e nevojave ekonomike, sociale dhe mjedisore.

ÇFARË MUND TË BËJMË PËR KËTË?

Në nivel lokal, ne duhet të bëjmë zgjedhje që mbrojnë oqeanin, kur blejmë produkte ose konsumojmë ushqime që vijnë nga oqeanet dhe konsumojmë vetëm atë që na nevojitet. Zgjedhja e produkteve të certifikuara është një mënyrë e shkëlqyer për të filluar. Ne duhet të eliminojmë përdorimin e plastikës sa më shumë që të jetë e mundur dhe të organizojmë pastrime të plazheve. Më e rëndësishmja, ne mund ta përhapim mesazhin për rëndësinë e jetës nënujore dhe pse kemi nevojë ta mbrojmë atë.

LEXO MË SHUMË PËR **OZHQ 14** →

OBJEKTIVI 15

JETA NË STERË

15 JETA NË STERË



OBJEKTIVI:

Pyje të administruar në mënyrë të qëndrueshme, lufta ndaj shkretëtirëzimit, rikuperimi i degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Pyjet tanë na sigurojnë ajrin që thithim dhe ujin që pimë, deri tek ushqimet që hamë. Niveli i biodiversitetit po ulet me ritme më të shpejta se në çdo kohë tjetër të historisë së njerëzimit. Degradimi i tokës rrezikon mirëqenien e 3.2 miliardë njerëzve, duke i shtyrë speciet drejt zhdukjes dhe intensifikimit të ndryshimit të klimës. Biodiversiteti dhe ekosistemi që ai mbështet, mund të jetë baza për përshtatjen dhe ndaj ndryshimeve klimatike dhe strategjive për uljen e rrezikut nga katastrofat.

ÇFARË MUND TË BËJMË NE?

Disa gjëra që mund të bëjmë për të ndihmuar përfshijnë riciklimin, konsumimin e dietave të bazuara tek produktet vendase, që rriten në mënyrë të qëndrueshme dhe të konsumojmë vetëm atë që na duhet. Ne duhet të respektojmë kafshët e egra dhe të marrin pjesë vetëm në mundësitë e eko-turizmit që drejtohen me përgjegjësi dhe etikë për të parandaluar ndërhyrjet ndaj jetës së egër. Zonat e menaxhuara dhe të mbrojtura mirë, mbështesin ekosistemet e shëndetshme, të cilat nga ana tjetër i mbajnë njerëzit të shëndetshëm. Është e rëndësishme të sigurohet përfshirja e komuniteteve lokale në zhvillimin dhe menaxhimin e këtyre zonave të mbrojtura.

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 15 →

OBJEKTIVI 16

PAQE, DREJTËSI DHE INSTITUCIONE TË FORTA

16 PAQE DREJTËSI IN-STITUCIONE TË FORTA



OBJEKTIVI:

Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe ndërton institucione

efektive, përgjegjëse dhe përfshirëse në të gjitha nivelet.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Njerëzit kudo nuk duhet të kenë frikë nga asnjë formë dhune dhe të ndihen të sigurt gjatë zhvillimit të jetës së tyre, pavarësisht nga përkatësia etnike, besimi apo orientimi i tyre seksual. Konflikti, pasiguria, institucionet e dobëta dhe qasja e kufizuar në drejtësi mbeten kërcënime për zhvillimin e qëndrueshëm.

ÇFARË MUND TË BËJMË NE?

Ushtroni të drejtën tuaj për llogaridhënie nga zyrtarët tuaj të zgjedhur. Ushtroni të drejtën tuaj për informim dhe ndani mendimin tuaj me përfaqësuesit tuaj të zgjedhur. Promovoni përfshirjen dhe respektin ndaj personave me etni, origjina, fe, gjini, orientime seksuale ose mendime të ndryshme.

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 16 →

OBJEKTIVI 17

PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT

17 PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT



OBJEKTIVI:

Rigjallëroni partneritetin global për zhvillim të qëndrueshëm.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm mbeten kuadri për ndërtimin e një botë më të mirë për të gjithë. Ne kemi nevojë që të bashkohen të gjithë - qeveritë, shoqëria civile, shkencëtarët, sektori akademik dhe sektori privat për të arritur këto objektivat deri në vitin 2030.

ÇFARË MUND TË BËJMË PËR TË NDIHMUAR?

Bashkohuni/krijoni një grup në komunitetin tuaj që kërkon të ndërmarrë veprime për zbatimin e OZHQ -ve. Inkurajoni qeveritë tuaja të bëhen partnere me bizneset për zbatimin e OZHQ-ve. Promovoni nismat tuaja në Platforma të ndryshme lokale dhe globale për të informuar, edukuar, krijuar lidhje dhe frymëzuar!

LEXO MË SHUMË PËR OZHQ 17 →

31

BURIME TË TJERA INFORMACIONI



Në internet ka shumë mundësi për të marrë informacion, duke filluar nga faqet e qeverisë deri tek organizatat partnere që janë duke punuar për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Nëse jeni në kërkim për më tepër informacion për OZHQ-të dhe mundësitë e zbatimit të tyre nga biznesi juaj ose në jetën e përditshme, ju mund të shikoni një përzgjedhje të burimeve të tjera të cilat janë të përmbledhura këtu:

BURIME TË TJERA



FALEMINDERIT

Për më shumë informacion për OZHQ-të referohuni tek Zyra e Kombeve të Bashkuara dhe Dhoma Ndërkombëtare e Tregëtisë në Shqipëri ose vizitoni:

www.albania.un.org

www.icc-albania.org.al

